



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 23/2021 (JR)
Nr. 23 / 6 regj.

Tiranë, më 20.06.2023

**SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË GJYQËSORE PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se sot, më datë 20.06.2023, në seancën e thirrur në orën 10:00, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri 23/2021, datë 10.05.2021, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Aleks Nikolli kundër vendimit nr. 290, datë 10.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, **ditën e mërkurë, në datën 12.07.2023, ora 10.30.**

Kolegji i Posaçëm i Apelimit e mori këtë vendim bazuar në nenin 51, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, pasi vendimi i Komisionit ndaj të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, për t’i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit për t’u dëgjuar lidhur me pasurinë apartament banimi me dy shtesat anësore, ndodhur në lagjen “Besëlidhja”, rruga “Kosova”, në qytetin e Lezhës.

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe në nenin 51, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES

GJYQTARE

ALBANA SHTYLLA

